

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 10.08.2015]

**Për: Bashkimin e Operatoreve ekonomike “Pevlaku” shpk (51%), me NIPT K61716013M dhe “Vuthaj” shpk (49 %), me NIPT K67812301C.**

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Sistemim – asfaltim i rrugës Sanxhak – superstradë, Bashkia Laç”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Sistemim – asfaltim i rrugës Sanxhak – superstradë, Bashkia Laç”.**

Kohëzgjatja: **4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **83,151,051 (tetëdhjetë e tre milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e një) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 25.06.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: <b>Nr</b>	<b>Operatori Ekonomik</b>	<b>Oferta (pa TVSH)</b>
1	COMPANY RIVIERA 2008 SHPK & SIRETA 2F SHPK	47,099,010
2	KTHELLA SHPK & NDREGJONI SHPK	58,361,375
3	ERAL KONSTRUKSION SHPK & A&E & HR99	60,700,841
4	BE IS SHPK & B93 SHPK	62,132,102
5	SHPRESA SHPK & AGRI KONSTRUKSION	67,043,814

	SHPK	
6	BAJRAMI N	69,050,579
7	GJOKA	71,836,590
	KONSTRUKSION SHPK	
8	EVEREST SHPK	73,541,423
9	PEVLAKU SHPK	78,231,235
10	ULZA NDERTIM SHPK	78,381,222
11	DENIS 05 SHPK	79,660,244
12	GENER 2 SHPK	82,451,029
13	SHKELQIMI 07 SHPK	NUK KA PARAQITUR OFERTE

### Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem me arsyet perkatese:

#### **Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Company Riviera 2008” shpk (49%) dhe “Sireta 2F” shpk (51%) per arsye se:**

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson kerkesen per gjendjen ne banke. Kjo kompani ka paraqitur nje vertetim se disponon gjendje ne banke ne masen 2.500.000 leke, nderkohe qe sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper i takon te kete 4.074.401 leke.

Shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nuk ploteson kerkesen per disponimin e mjeteve dhe te stafit, pasi mjeti “Fadrome me goma” ABMT 61 si dhe “Gurethyes” eshte deklaruar edhe ne objektin “Sistemim asfaltim i rruges së fshatit Mal- Bardhë deri te kisha e Shën Mëhillit”, sipas kontrates se lidhur me Fondin Shqiptar te Zhvillimit. Ky fakt perben nje deklarim te rreme me qellim kualifikimi. Po ashtu edhe I gjithe stafi I deklaruar eshte i angazhuar ne kontraten me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges së fshatit Mal- Bardhë deri te kisha e Shën Mëhillit”, lidhur me Fondin Shqiptar te Zhvillimit.

Shoqeria “Sireta 2F” shpk me mjetet qe ka deklaruar se disponon nuk mund te kryeje punimet qe ka marre persiper. Nga marreveshja e bashkepunimit rezulton se kjo kompani ka marre persiper te kryeje punime germimi, mbushje, betoni, shtresa etj nderkohe qe nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje autoboti, frantoje, autobitumatrice, rul me goma etj.

#### **Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Kthella” shpk (73.013%) dhe “Ndregjoni” shpk (26.987%) per arsye se:**

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson kerkesen per disponimin e mjeteve. Nga marreveshja e bashkepunimit rezulton se kjo shoqeri ka marre persiper te kryeje punimet per zerin “Shtrese asfalto betoni 4 cm + sperkatje me emulsion”, nderkohe qe nga deklarata per disponimin e makinerive rezulton se nuk disponon makineri asfaltoshtuese dhe rul me goma per ngjeshjen e asfaltit.

#### **Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Eral Konstruksion ” shpk (85%), “A&E” shpk (14%) dhe “HR 99” shpk (1%) per arsye se:**

Shoqeria “Eral Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen per numrin e nevojshem te punonjesve. Sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper i takon te kete mesatarisht 59 punonjes ne muaj, nderkohe qe ka paraqitur dokumentacion qe verteton se ne muajin janar ka 54 puntore, shkurt 53, mars 48, prill 47 dhe maj 53, me nje mesatare prej 51 punonjesish, duke mos plotesuar kushtin.

Shoqeria “Eral Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti kjo kompani ka paraqitur :

Kontraten me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Tepelene– Gusmar”, me vlere 306.632.777 leke me tvsh lidhur me shoqerine “Kirchberger Albania” shpk. Nga shqyrtimi I dokumentacionit rezulton se shoqeria “Kirchberger Albania” shpk I ka nenkontraktuar shoqerise “Eral Konstruksion” shpk te gjithë punen pa mare me pare miratimin e autoritetit kontraktor, nderkohe qe ne nenin 45 te kontrates se lidhur midis “Kirchberger Albania” shpk dhe autoritetit kontraktor “Autoriteti Rrugor Shqiptar” ndalohet nenkontraktimi pa miratimin paraprak me shkrim te autoritetit kontraktor. Gjithashtu edhe ne nenin 61 te Ligjit “Per Prokurimin Publik” kufizohet nenkontraktimi deri ne nje vlere maksimale prej 40% te kontrates se punes. Ne kete menyre kontrata mes “Kirchberger Albania” shpk dhe “Eral Konstruksion” shpk eshte lidhur ne kundershtrim me ligjin dhe si e tille nuk mund te merret parasysh si pune e ngjashme.

Kontraten “Mbrotjtja nga lumi Shkumbin, zona Kular Divjake”. Kjo kontrate nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me rrugen qe prokurohet.

Kontraten “Mbrotjtje nga gerryerja e lumit Kserias, Vrisera, Gjirokaster”. Kjo kontrate nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me rrugen qe prokurohet.

Kontraten “Projekte ne parkun e Viroit Gjirokaster”. Kjo kontrate nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi vlere totale e punimeve ne trupin e rruges, sipas situacionit perfundimtar, kap shifren 5.762.234 leke duke mos plotesuar vleren e kerkuar. Gjithashtu nuk eshte paraqitur marreveshja e bashkepunimit per te gjykuar mbi punet konkrete te realizuara nga shoqeria “Eral Konstruksion” shpk.

Kontraten “Rehabilitimi i sistemit kulues k1”. Kjo kontrate nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me rrugen qe prokurohet.

Kontraten “Rehabilitimi i rruges Tosk Martallos”, me vlere 21.401.920 leke pa tvsh. Kjo pune nuk ploteson kushtin pasi ne DST vlere per nje pune te vetme kerkohet jo me pak se 41,575,530 leke pa tvsh. Ne kete menyre kjo shoqeri nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme.

Shoqeria A&E” shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti kjo kompani ka paraqitur kontraten “Ndertim kabinash elektrike dhe rrjet TU”. Kjo kontrate nuk mund te konsiderohet si pune e ngjashme, pasi nuk ka asgje te perbashket me rrugen qe prokurohet.

Shoqeria “HR 99” shpk nuk ploteson kushtin per shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur nje kontrate me OSHEE per shlyerjen me keste, por kontrata eshte ne ngarkim te zotit Hamza Shabani dhe jo te shoqerise. i gjithë dokumentacioni i paraqitur eshte i muajit janar 2015, dhe nuk ka asnje dokument qe te provoje se shoqeria nuk ka detyrime ndaj OSHEE.

Shoqeria “HR 99” shpk nuk ploteson kushtin per realizimin e puneve te ngjashme pasi per punen e deklaruar nuk ka paraqitur formularin e vleresimit.

Shoqeria “HR 99” shpk nuk ploteson kushtin per stafin e kerkuar, pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per ing ndertimi Ana Balili, por nuk ka paraqitur diplomen sic kerkohet ne DST.

**Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Be - Is ” shpk (60%) dhe “B - 93” shpk (40%) per arsye se:**

Shoqeria “B - 93” shpk nuk ploteson kushtin per stafin e kerkuar. Nga marreveshja e bashkepunimit rezulton se kompania “Be Is” shpk ka marre persiper te kryeje punimet e shtresave rrugore (zerat 1,4,5 dhe 6) ndersa “B 93” shpk ka marre persiper te kryeje te gjitha punimet e germimit, mbushjeve dhe themeleve dhe nuk ka ne stafin e saj inxhinier gjeolog.

Shoqeria "B - 93" shpk nuk ploteson kushtin per disponimin e makinerive. Nga marreveshja e bashkepunimit rezulton se kompania "Be Is" shpk ka marre persiper te kryeje punimet e shtresave rrugore (zerat 1,4,5 dhe 6) ndersa "B 93" shpk ka marre persiper te kryeje te gjitha punimet e germimit, mbushjeve dhe themeleve nderkohe qe ka deklaruar se disponon vetem nje makineri greider nga dy qe duhet te kishte.

Shoqeria "Be - Is" shpk nuk ploteson kushtin per disponimin e makinerive. Nga marreveshja e bashkepunimit rezulton se kompania "Be Is" shpk ka marre persiper te kryeje punimet e shtresave rrugore (zerat 1,4,5 dhe 6) dhe ne kete menyre duhet te dispononte te gjitha mjetet e nevojshem per shtresat rrugore. Faktikisht disponon vetem nje asfaltoshtruese nga dy qe kerkohet ne kerkesat per kualifikim.

### **Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Shpresa" shpk (35%) dhe "Agri Konstruksion" shpk (65%) per arsye se:**

Bashkimi i shoqerive nuk eshte bere ne perputhje me nenin 74, pika 2, te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku nder te tjera citohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi"*. Ne marreveshjen e lidhur para noterit eshte percaktuar vetem perqindja e pjesemarrjes per secilen shoqeri dhe nuk jane percaktuar elementet konkrete te punes qe do te kryeje secili nga anetaret e bashkimit. Ndarja e puneve eshte e panoteruar. Kjo e mete, bazuar ne vendimin e komisionit per shqyrtimin e ankesave, eshte konsideruar si e mete e vogel qe nuk demton thelbin e ofertes.

Shoqeria "Shpresa" shpk nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme. Kjo shoqeri ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit: "Rikonstruksion i rruges Fabrika e Qelqit" dhe shtese kontrate per objektin "Rikonstruksion i rruges Fabrika e Qelqit" me vlere totale 63.918.714 leke pa tvsh, realizuar si bashkim shoqerish me shoqerine "Derveni 1" shpk. Shoqeria "Shpresa" shpk, sipas formularit te vleresimit, ka realizuar 30% te punimeve, pra 19.175.614 leke pa tvsh. Per kete objekt shoqeria "Shpresa" shpk nuk ka paraqitur marreveshjen e bashkepunimit ne menyre qe te gjykohet mbi punet konkrete qe ka realizuar dhe as faturat tatimore qe ajo ka leshuar per punen e kryer. Faturat tatimore te paraqitura, pra ato qe shoqeria "Derveni 1" shpk ka deklaruar, nuk provojne se nje pjese e punes eshte kryer nga shoqeria "Shpresa" shpk. Faturat tatimore jane nje element i rendesishem qe jep mundesine te gjykohet per vleren totale te punes qe ka kryer operatori ekonomik.

Shoqeria "Agri Konstruksion" shpk nuk ploteson kushtin per pagesen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetim lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore per komunen Yzberisht ne te cilen operatori ekonomik ushtron aktivitet.

### **Shoqeria "Bajrami N" shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kerkesen per disponimin e mjeteve pasi pjesa me e madhe e mjeteve te deklaruar ne kete objekt jane te angazhuara ne kontraten me objekt: "Ndertim i shetitores, kuz, tek liqeni i Farkes, komuna Farke", prokuruar nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit. Po ashtu edhe stafi teknik eshte i angazhuar ne Farke, sipas deklarates perkatese.

Nuk ploteson kerkesen per disponimin e stafit pasi stafi i deklaruar ne kete objekt eshte i angazhuar ne kontraten me objekt: "Ndertim i shetitores, kuz, tek liqeni i Farkes, komuna Farke", prokuruar nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit.

### **Shoqeria "Gjoka Konstruksion" shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kushtin per pagesen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetim lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore per komunat Dajt dhe Xiber ne te cilat operatori ekonomik ushtron aktivitet.

Nuk ploteson kerkesen per per disponimin e stafit pasi nuk ka inxhinier gjeolog ne stafin e vet. Dokumentacioni I paraqitur per ing. Gjeolog eshte I pavlefshem, pasi kontrata me inxhinierin ka perfunduar qe ne daten 28 Shkurt 2015.

**Shoqeria “Everest” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kushtin per pagesen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetim lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore per komunen Kashar ne te cilat operatori ekonomik ushtron aktivitet.

Nuk ploteson kerkesen per gjendjen ne banke, pasi nuk ka paraqitur vertetimin perkates.

**Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Ulza Ndertim” shpk (76%) dhe “Almo Konstruksion” shpk (24%) per arsye se:**

Shoqeria „Ulza Ndertim” shpk nuk ka paraqitur deklaraten mbi gjendjen gjyqesore sipas shtojces 11, deklaraten mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5, deklarate mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7 dhe deklaraten mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 te DST.

**Bashkimi i perkohshem i shoqerive “Denis 05” shpk (65%) dhe “Arifaj” shpk (35%) per arsye se:**

Shoqeria “Arifaj” shpk nuk ploteson kushtin per pagesen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetim lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore per Kavajen dhe komunen Xhafzotaj ne te cilat operatori ekonomik ushtron aktivitet.

**Shoqeria “Gener 2” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kushtin per shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti ka paraqitur nje vertetim nga OSHEE ku figuron me detyrime te pashlyera ne masen 859.223 leke. Ne vertetim citohet se kjo vlere eshte ankimuar dhe eshte ne proces trajtimi nga OSHEE. Duke qene se ky detyrim nuk eshte ankimuar ne gjykate, referuar nenit 26, pika 7, germa “c” te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”, shoqeria duhet te skualifikohet.

**Shoqeria “Shkelqimi 07” shpk per arsye se nuk ka paraqitur oferte.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e Operatoreve ekonomike “Pevlaku” shpk (51%) & “Vuthaj” shpk (49 %) se oferta e paraqitur, me vlerë 78.231.235 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi përfundimtar i Klasifikimit është bërë në datë **29.07.2015**.

Ankesa: Në datën 27.07.2015 ka paraqitur ankim shoqëria "Shpresa" shpk. Ankimit i është kthyer përgjigje në datën 28.07.2015, ndersa ne daten 29.07.2015 u be rivleresimi në sistem.

